

VENDIM
Nr.779, datë 22.11.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.335, DATË 2.9.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE SHËRBIMIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8668, datë 23.11.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në paragrafin e tridhjetë të pikës 4 të vendimit nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas fjalëve “...politik e social...” shtohen “...dhe drejtori, kryeredaktori dhe shefi i sektorit me jashtë, të mediave elektronike.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha